

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D I M

Nr. 1, datë 21.6.2006

PËR

REDUKTIMIN E SHFRYTËZIMIT TË ZHAVOREVE DHE RËRAVE NË SHTRETËRIT E LUMENJVE

Në mbështetje të neneve 6 e 20, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, "Për rezervat ujore", si dhe të studimit "Vlerësimi i pasojave, ndikimit mjedisor problemeve hidrodinamike dhe rehabilitimi i gjendjes në shtretërit e lumenjve", i realizuar në zbatim të vendimit nr.760, datë 13.11.2003, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Shfrytëzimi i zhavorreve dhe i rërave në shtretërit e lumenjve lejohet vetëm kur, nga institucionet e specializuara, studimore dhe projektuese, në fushat e hidraulikës, hidroteknikës, hidrologjisë, gjeologjisë, tokave, pyjeve, mjedisit etj, si dhe në monitorimin e autoriteteve të ujit, janë realizuar studimet e projektet e nevojshme për shfrytëzimin e zhavorreve e rërave dhe për rehabilitimin e zonave, që do të shfrytëzohen.

2. Shfrytëzimi i zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve lejohet vetëm kur, sipas studimeve të kryera nga institutet e specializuara, ka depozitime të mjaftueshme, dhe vetëm në segmentet e mëposhtme:

2.1 Në basenin Drin-Bunë

- a) Në lumin Bunë, nga bashkimi i tij me lumin Drin deri 1 km më poshtë.

b) Në lumin Kir, në të gjithë gjatësinë e tij.

2.2 Në basenin Mat

a) Në lumin Mat:

- Segmenti nga bashkimi i lumit Mat me lumin e Fanit, deri në 500m mbi Urën e Zogut.

- Segmenti nga Ura e Milotit (500m nën urën e autostradës) deri në fshatin Gurzë.

b) Në lumin e Fanit, në segmentin 500m nën urën e Rrëshenit deri në bashkimin e tij me lumin Mat.

2.3. Në basenin Shkumbin

a) Në lumin Devoll, gjatë të gjithë rrjedhës së tij.

b) Në lumin Shkumbin, në segmentin 500m mbi urën e autostradës, Peqin, deri në rrjedhën e sipërme, me përjashtim të zonës së banuar të qytetit të Elbasanit, (segmenti që përfshihet në koordinatat: X1=4422000, Y1=4551000, X2= 4422000, Y2=4551700 ; X3=4426000, Y3=4552100 ; X4=4426000. Y4=4553000.).

2.4. Në basenin Seman

a) Në lumin Seman, në të gjithë gjatësinë e tij, me përjashtim të zonës së fshatit Verri, përballë Marinzës.

b) Në lumin Osum, në të gjithë gjatësinë e tij, me përjashtim të zonës 500m mbi Urën Vajgurore e deri në bashkimin me lumin Devoll, si dhe të zonës së banuar të qytetit të Beratit, (segmenti që përfshihet në kordinatat : X1=4506860, Y1=4412910 ; X2=4506820, Y2=4412880 ; X3=4509860, Y3=4410510 ; X4=4509860, Y4=4410345.).

2.5. Në basenin Vjosë

a) Në lumin Vjosë:

- Segmenti nga fshati Dragot deri në bashkimin me lumin Drino.

- Segmenti nga derdhja e lumit të Bençës në Vjosë deri në përroin e Damësit.

- Segmenti nga meandrimi i Qesaratit deri në grykën e Përroit të Krasit.

- Segmenti nga fshati Poçem, deri në 5 km mbi urën e Mifolit.

b) Në lumin Shushicë, në segmentin nga Kota deri në bashkimin me lumin

Vjosë.

- c) Në lumin Drino, nga rezervuari i Viroit deri në rrjedhën e sipërme.
- ç) Në lumin Bistricë, në zonën e Mesopotamit.
- d) Në lumin Kalasë, gjatë të gjithë rrjedhës së tij.

3. Shfrytëzimi i inerteve lumore lejohet vetëm për periudhën 1 qershor- 31 tetor, të çdo viti.

4. Shfrytëzimi i inerteve lejohet deri në thellësinë 0.5m mbi nivelin minimal të pasqyrës së ujërave nëntokësore.

5. Sasia e materialit, që merret nga çdo subjekt, të jetë jo më shumë se 50 për qind e prurjeve të ngurta vjetore të zonës, që është miratuar për shfrytëzim.

6. Kërkesat e pikave 4 e 5, të këtij vendimi, zbatohen edhe nga subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Subjektet e pajisura me leje, në zona të ndaluara për shfrytëzim nga ky vendim, lejohen të punojnë me inerte lumore deri më 31 tetor 2006.

8. Brenda vitit 2006 të hiqen të gjitha impiantet e përpunimit të inerteve dhe materialet e grumbulluara, që ndodhen brenda argjinaturave dhe në shtretërit e lumenjve.

9. Lejet e shfrytëzimit jepen në përputhje me ligjin nr.8093, datë 21.3.1996, "Për rezervat ujore", dhe me procedurat e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

10. Vendimi nr. 1, datë 9.1.2003, i Këshillit Kombëtar të Ujit, "Për shfrytëzimin e zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve", shfuqizohet.

11. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe këshillat e baseneve ujëmbledhëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
SALI BERISHA

ZËVENDËSKRYETARI
LUFTER XHUVELI